



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:121886

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05544833

**P.nr../..**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL** gjyqtari i vetëm gjykues Musë Povataj, me pjesëmarrje të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit N.. M.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1095/22 të datës 14.06.2022, jashtë seancës gjyqësore me datë 04.04.2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. e datës ....., lidhur në mes të pandehurit N.. M.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

**II. HUDHET** aktakuza e Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti i Përgjithshëm PP/II nr.1325/22 të datës 25.07.2022.

**III. PUSHOHET** procedura penale ndaj të pandehurit **N.. M..**, i lindur më datën ..... në P..., ku edhe banon në rr. "T.." nr. .., i biri i Z.. dhe nënës Z..., posedon nr. tel ....., i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr....., i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i R. Kosovës,

- për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

**A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamentit të Përgjithshme me datën 23.07.2021 ka ngritur aktakuzën PP/II nr.1095/22 ndaj të pandehurit N.. M.. për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par. 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Me datën 28.03.2024 është arrit marrëveshja në zyrën e ndërmjetësimit në mes të pandehurit R.. K.. dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P.. e cila marrëveshje i është dozuar gjykatës ne kopje të mjaftueshme.

Nga te cekurat me lartë gjykata ka vendosur si ne pikën I të dispozitiv të këtij aktvendimi duke e pranuar marrëveshja për ndërmjetësim Nd.nr../.. datës ....., lidhur në mes të pandehurit dhe përfaqësuesit të autorizuar të palës së dëmtuar K.. sh.a në P...

Me dispozitën ligjore të nenin 229 par. 5 të KPRK-së është përcaktuar se: nëse aktakuza është dorëzuar, gjyqtari i vetëm gjykues, nëse e pranon formalisht marrëveshjen, merr vendim për të hedhur aktakuzën dhe e ndërprejë procedurën penale.

Andaj nga të cekurat më lartë e në kuptim 229 par.5 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM ,  
DIVIZIONI PENAL  
2022:121886, 04.04.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Gj y q t a r i**

\_\_\_\_\_  
Edona Berisha Kastrati

\_\_\_\_\_  
Musë Povataj

**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij aktvendimi palët kanë te drejtë të parashirojnë ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë përmes kësaj Gjykate, në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktvendimi